REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
Njesia Org. / Org.Jedinica / Org.Unit: AMMK
Nr.Prot / Broj.Prot / Prot.No.: 6199/18
Nr. i faqeve / Broj.strana / No.pages: 1
Data / Datum / Date: 24.10.2018
Prishtinë / a

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS | **KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE** | **KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY**

DATË/A:	24/10/2018
REFERENC-Ë:	1166 IKMN/2018
PËR/ZA/TO:	Dr.sc. Ilir Morina, Kryeshef i AMMK-së Muhamet Malësiu, Drejtor i DMMU-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Fadil Bajraktari, Drejtor i IKMN-së
NGA/OD/FROM:	Nexhmije Kamberi, Kryesuese e Grupit Punues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për procedimin e mëtutjeshëm të Arsyeshmërisë profesionale "Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicë"

Të nderuar,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 12.01.2018, ka nxjerre Vendimin Nr. 85, për vënien nën Mbrojtje Paraprake të një pjese të Malit Pashtrik dhe Liqenit të Vërmicës si zonë potenciale për shpallje vlerë e mbrojtur e natyrës në kategorinë e Parkut Natyror/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare.

Me Vendim Nr. 38/AMMK/2018 të datës 08.02.2018 është formuar Grupi Punues, i cili ka hartuar Arsyeshmerinë profesionale për marrjen nën mbrojtje "Malin Pashtrik dhe Liqenin e Vërmicës", si dhe shpalljen e kësaj zone Park Natyror/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233, Neni 20, ky dokumenet ka qenë në Debat Publik nga data 12 Shtator deri me 12 Tetor 2018. Pas përfundimit të tij Grupi Punues ka bërë plotësimin e dokumentit me komente dhe sygjerimet e publikut dhe sipas legjislacionit në fuqi, kërkohet që të procedohet me nxjerret Vendimi për këtë zonë.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" ish pallati i mediave"Rilindja", kati XV/04, 10000 Prishtinë
Tel. 038 200 33 228, e-mail&web: KEPA@ks-gov.net, www.akmm-rks.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Arsyeshmëria profesionale për marrjen nën mbrojtje Malin Pashtrik dhe Liqenin e Vërmicës në kategorinë Park i Natyrës/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare

Prishtinë, 2018

PËRMBAJTJA

HYRJE....3
BAZA LIGJORE....3
OBJEKTIVAT....4
KARAKTERISTIKAT FIZIKO – GJEOGRAFIKE....5
Pozita gjeografike e Malit Pashtrik....5
Ndërtimi gjeologjik dhe tektonika....5
Relievi....7
Klima....7
Hidrografia....7
Veçoritë pedologjike....8
MALI PASHTRIK....8
GJENDJA EKZISTUESE NË MALIN PASHTRIK....9
LIQENI I VËRMICËS....9
GJENDJA EKZISTUESE NË LIQENIN E VËRMICËS....10
BIODIVERSITETI I PASHTRIKUT....11
Flora....12
Llojet endemike të Ballkanit....14
Llojet bimore relikte në Pashtrik....15
Llojet bimore të rrezikuara....15
Llojet bimore të reja për Pashtrikun....16
Vegjetacioni....16
Pyjet e shkozës së zezë dhe të bardhë....17
Pyjet e dushkut....17
Pyjet e ahut....19
Pyjet halore....19
Fauna....20
BIODIVERSITETI I LIQENIT TË VËRMICËS....24
VLERAT PEIZAZHORE E MALIT TË PASHTRIKUT DHE LIQENIT TË VERMICES....25
VEPRIMTARIA EKONOMIKE E MALIT TË PASHTRIKUT DHE LIQENIT TË VERMICËS....27
ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI ME ZONËN....29
PËRFUNDIM....30
Projektet komunale të planifikuara në zonën e propozuar për mbrojtje....33
LITERATURA....34

HYRJE

Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës është zonë e rëndësishme e biodiversitetit, jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Bazuar në raportet e bëra nga ekspertët në terren është konstatuar se kjo zonë është e pasur në aspektin gjeologjik, pedologjik, floristik, faunistik etj. Liqeni i Vërmicës i cili është krijuar në rrjedhën e poshtme të Drinit të Bardhë në dalje të lumit në territorin e Shqipërisë karakterizohet me vlera të veçanta biologjike, biogjeografike, gjeologjike, hidrologjike dhe peizazhore. Në ketë zonë Lumi ka krijuar gryken epirogjenike e cila paraqet monument të rëndësishëm të karakterit gjeomorfologjik.

Ekspertët nga Universiteti i Prishtinës, gjatë periudhës së vitit 2012 – 2015, kanë realizuar hulumtime në këtë zonë, me qëllim të vlerësimit të situatës reale të biodiversitetit. Bazuar në studimin për vlerat natyrore, konstatohet se Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës shquhet me vlera natyrore, shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, arkeologjike, kulturore, peizazhore, edukativo-arsimore e turistike dhe propozohet të shpallet si "Peizazh i Mbrojtur", ose "Park Kombëtar"[1].

BAZA LIGJORE

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 12.01.2018, ka nxjerre Vendimin Nr. 85, për vënien nën Mbrojtje Paraprake të një pjese të Malit Pashtrik dhe Liqenit të Vërmicës si zonë potenciale për shpallje vlerë e mbrojtur e natyrës në kategorinë e Parkut Natyror/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare – në sipërfaqe prej rreth 6.000 hektar.

Pjesa e propozuar për vënien nën mbrojtje ligjore shtrihet në territorin e Komunave Gjakovë dhe Prizren, të cilat kanë dhënë aprovimin e tyre.

Me Vendim Nr. 38/AMMK/2018 të datës 08.02.2018 është formuar Grupi Punues për hartimin e Arsyeshmerisë profesionale për marrjen nën mbrojtje "Malin Pashtrik dhe Liqenin e Vërmicës", si dhe shpalljen e kësaj zone Park Natyror/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare, të parapare me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233, Parku i Natyrës paraqet zonë të madhe natyrore ose pjesërisht artificiale të tokës dhe ose ujit me karakteristika ekologjike të rëndësisë kombëtare e ndërkombëtare me vlera të theksuara të larmisë peizazhore, edukative-arsimore, kulturo-historike dhe turistike-rekreative, në të cilin lejohen veprimtarit ekonomike dhe aktivitetet tjera me të cilat nuk rrezikohet roli dhe karakteristikat e rëndësishme të tij.

Shpalljen e vlerës së mbrojtur natyrore si Park i Natyrës/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës", e bënë Qeveria e Republikës së Kosovës.

[1] Prof.Dr. Behxhet Mustafa, Dr.Sc. Avni Hajdari dhe Msc. Bledar Pulaj, Raporti Mbi Vlerat e Biodiversitetit të Pashtrikut-Morinës

Propozimi i aktit për shpalljen e kësaj zone në kategorinë Park i Natyrës/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare, bazohet në këtë propozim profesional, me të cilin përcaktohen vlerat e zonës të cilat propozohen të ruhen dhe mbrohen, mënyra e administrimit me zonën dhe propozimi i organit i cili nxjerr aktin për shpallje, si dhe sigurimin e mjeteve për administrimin me këtë zonë.

Baza profesionale përmban përshkrimin në detaje të veçorive dhe të vlerave të zonës e cila mbrohet, vlerësimi i gjendjes së asaj zone dhe vlerësimin e mjeteve të duhura për zbatimin e aktit për shpallje të zonës së mbrojtur Park Natyre/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare.

Procedurën e qasjes publike për vënien nën mbrojtje të kësaj zone e organizon dhe e udhëheqë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

OBJEKTIVAT

Malet e Pashtrikut së bashku me rrjedhën e Drinit të Bardhë - Liqenin e Vërmicës përmbajnë vlera të veçanta natyrore, peizazhore dhe biodiversitetit, si dhe karakteristikave tjera duhet të merret nën mbrojtje ligjore dhe njëkohësishtë të jenë zonë lidhëse përtej kufirit.

Qëllimet që synohen të arrihen pas shpalljen e kësaj zone janë:

- Mbrojtja e ekosistemit dhe diversitetit biologjik, menaxhimi i qëndrueshëm si dhe marrja e masave për revitalizimin e vlerave natyrore të dëmtuara në zonën ndërkufitare
- Mbrojtja e ekosistemit dhe diversitetit biologjik, menaxhimi i qëndrueshëm si dhe marrja e masave për revitalizimin e ekosistemeve të dëmtuara ne hapësirën e propozuar për mbrojtje të kësaj zone ndërkufitare
- Shfrytëzimi racional i vlerave natyrore përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit të zonës për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të sajë
- Ndërmarrja e veprimtarive të përshtatshme të ruajtjes dhe menaxhimit, me qëllim të rivendosjes së kushteve ekologjike në ekosistemet dhe habitatet
- Vazhdimi i hulumtimeve kërkimore-shkencore, arsimore, kulturore, edukative dhe punëve të tjera profesionale në pajtim me konceptet ndërkombëtare në zhvillimin e zonave ndërkufitare me synim ruajtjen e natyrës, zhvillimin e turizmit dhe promovimin e prodhimeve vendore
- Promovimi i vlera dhe zhvillimi ekomomik i zonës ndërkufitare Kosovë – Shqipëri
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave për gjatë gjithë pellgut të Drinit të Bardhë

KARAKTERISITKAT FIZIKO – GJEOGRAFIKE

Pozita gjeografike e Malit Pashtrik

Rajoni i Pashtrikut shtrihet në jug-perëndim të Kosovës, që fillon prej Qafës së Prushit në veri dhe arrin në jug deri te Lugina e Drinit të Bardhë, në Vërmicë. Ndërkaq në lindje si kufi e përshkon Lumi Drini i Bardhë, e nga perëndimi atë e ndan Kufiri Kosovë-Shqipëri. Lartësia mbidetare fillon nga pika më e ulët 256 metra buzë Drinit deri tek lartësia më e madhe prej 1.989 metra e që është Maja e vet Pashtrikut. Rreth 1/3 e territorit të Pashtrikut gjendet në pjesën e Kosovës, ndërsa pjesa tjetër në Shqipëri. Malet e Pashtrikut shtrihen ndërmjet Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" dhe përbëhet nga shkëmbinjtë gëlqeror në jugu dhe shkëmbinjtë serpentinë në veri.



Fig. 1. Pozita gjeografike e Pashtrikut & LV

Ndërtimi gjeologjik dhe tektonika

Roli i proceseve gjeologjike është shumë i rëndësishëm dhe kryesor në krijimin e vlerave natyrore. Përbërja shkëmbore përcakton pamjen e trevës së caktuar dhe ndikon në proceset e ndryshme natyrore[2]. Pashtriku ka një përbërje gjeologjike mjaft të larmishme për nga koha e krijimit dhe llojllojshmërisë së përbërjes litologjike. Në ndërtimin e tij sipërfaqe të konsiderueshme zënë shkëmbinjtë bazikë të triasikut, megjithatë, pjesa më e madhe e kësaj hapësire ndërtohet nga formacionet karbonatike të kretakut të sipërm, të cilat shtrihen në pjesën jugore e lindore, ndërsa në drejtim të perëndimit ngushtohen.

Mali Pashtrik që gjendet në lartësi 1989 metra, u krijua nga lëvizjet e reja tektonike, në orogjenezën alpine. Ai u ndërtua kryesisht nga shkëmbinjtë karbonatikë të kretakut, të cilët janë sedimentuar mbi formacionet ultrabazike. Këtu janë të zhvilluara shumë dukuri karstike, për këtë rolin kryesor e kanë luajtur trashësia e konsiderueshme e gëlqerorëve (nga 400-500 metra deri 800-1000 metra). Karakteri shtresëmesëm dhe copëtimi i madh i tyre nga lëvizjet e reja tektonike është mjaft aktive edhe sot, reshjet e pasura të borës dhe mbulesa bimore relativisht e pasur[3].

---

[2] Ruzhdi Pllana, Gjeografia fizike, Prishtinë, 2003, f. 15
Grup autorësh, Gjeografia fizike e Shqipërisë II, Tiranë, 1991, fq. 116

[3] Grup autorësh, Gjeografia fizike e Shqipërisë II, Tiranë, 1991, fq. 116.

Në majën e Pashtrikut në një sipërfaqe prej 8.8 km^2 është krijuar **peizazhi karstik i Pashtrikut.** Dimensionet e formave sipërfaqësore janë mjaft të mëdha, si: hurdhat me diametër 10-30 deri 60-200 metra, me thellësi 30-200 metra, përmendoret e natyrës, të cilat për shkak të kompaktësisë se tyre nuk i janë nënshtruar tretjes, si dhe struktura shtresore e shkëmbinjve, janë disa nga specifikat natyrore që e karakterizojnë majën e Pashtrikut. Hapësira e gëlqerorëve fillon të ngushtohet nga fshatrat Lukinaj, Romajë e Kushnin në drejtim të perëndimit, duke i lëshuar vendin depozitimeve terrigjene në pjesën kodrinore-malor.



Fig. 2. Harta gjeologjike e zonës së propozuar për mbrojtje

Si pasoj e përhapjes së gëlqerorëve Pashtriku dallohet për një llojllojshmëri të formave tipike karstike, të përmasave të ndryshme. Këtu janë mjaft prezentë format sipërfaqësore (skribat, vorbullat dhe hurdhat), si dhe ato nëntokësore (humnerat dhe shpellat). Shpellat si forma më të

rëndësishme nëntokësore në territoret karstike, që janë krijuar si rezultat i veprimit kimik të ujit në shkëmbinjtë gëlqerorë, në territorin e Pashtrikut i gjejmë kryesisht në fazën iniciale të zhvillimit. Shpellat kryesore të njohura janë: Shpella e Pëllumbave, Shpella e Qirinjve, Shpella e Veselit, Shpella e Borës, Shpella e Gerqinës etj, si dhe një numër i madh në afërsi të zonës siq janë: Shpella e Kusarit, Shpella e Novakit etj.

Relievi

Në pikëpamje të reliefit, Pashtriku ndahet në tri tërësi morfologjike: në pjesën verilindore dhe lindore shtrihet fusha aluviale e Drinit, e cila e përbën tërësinë e parë dhe shtrihet përgjatë rrjedhës së lumit në formë të një rripi të gjatë. Ndërsa prej fshatit Rugovë deri në Lukinaj dhe prej Krajku deri ne Gjonaj, zgjerohet ne një gjerësi rreth 2 - 5 km. Në pjesën e poshtme të rrjedhës së Lumit, uji e ka thelluar shtratin duke tretur shkëmbinjtë, kështu ka formuar të ashtuquajturën Gryka e Gjonajve. Tërësia e dytë relievore fillon në jug dhe jugperëndim të rrafshit aluvial ku shtrihet edhe rrafshi i Liqenit të dikurshëm të Dukagjinit që përbënë Pellgun tektonike, e cila përbëhet prej shtresave të shkëmbinjve sedimental të neogenit si dhe tokës argjilore - zallore. Tërësinë e tretë e përbëjnë viset malore dhe kodrinore në majën më të lartë të malit Pashtrik dhe bëjnë pjesë në zonën perëndimore të vargmaleve më të reja të vendit.

Klima

Në rajonin e Pashtrikut mbretërojnë dy tipe klimatike, ajo kontinentale me elemente të klimës mesdhetare, që përfshin pjesën e Drinit të Bardhë dhe klima malore, në pjesën kodrinore, e cila mundëson verërat të nxehta dhe me pak të reshura. Mesatarja e temperaturës në muajt Korrik-Gusht është 22.7 ^{o}C. Gjatë dimrit temperaturat janë të ulëta, ku mesatarja e temperaturës në Janar-Dhjetor është 0.5 - 3 ^{o}C, temperatura mesatare vjetore sillet rreth 12 ^{o}C.

Hidrografia

Hidrografia e terrenit të hulumtuar përbëhet nga rrjeta e ujërave mjaft të varfër. Ujërat të cilat hasen këtu, kryesisht janë rrëzë malit në formë të burimeve karstike nga se rajoni përbehet kryesisht nga gurët gëlqerorë. Pjesa kodrinore dhe malore është e varfër me burime. Që të gjitha këto burime derdhen në lumin e Drinit, kurse sasia e ujit varet nga reshjet atmosferike. Prej ujërave më të njohur janë Drini i Bardhë dhe Dështica, si dhe disa burime karstike të cilat ndodhen jashtë zonës së propozuar për mbrojtje.

Veçoritë pedologjike

Tokat e kësaj zone janë zhvilluar kryesisht mbi shkëmbinjtë ultrabazikë, gëlqerorë e argjilorë. Toka e kuqe - terra rosa, është produkt i tretjeve krastike të shkëmbinjve karbonatikë dhe është përbërësi kryesor pedologjik, mbi formacionet karbonatike. Tokat e kafenjta livadhore e përbëjnë pjesën dërmuese të tokave bujqësore dhe shtrihen në luginat dhe gropat e kësaj zone deri në lartësitë 500 metra. Këto janë zhvilluar kryesisht mbi formacionet ultrabazike e shumë pak në ato gëlqerore, në pjesën veriperëndimore të Hasit nga fshati Goden e deri te fshati Devë. Tokat e murrme pyjore malore kanë një shtrirje relativisht më të vogël, sepse lartësitë 1100-1400 metra ku ato gjenden, zënë një sipërfaqe të kufizuar. Mbi to gjenden tokat livadhore malore, të cilat shtrihen vetëm rreth majës së Pashtrikut, në lartësi 1400-1900 metra. Tokat argjilore, në pjesën qendrore kodrinore-malore në fshatrat Blinishtë, Gerqin, Damjan, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të tokave bujqësore. Njëherit këto cilësohen si toka me veti prodhuese mesatare dhe si të përshtatshme për kultivimin e hardhisë së rrushit dhe duhanit.



Fig. 3. Harta dhe ortofoto e zonës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës", e propozuar për mbrojtje

MALI PASHTRIK

Pashtriku është një territor i vogël me vlera të shumta natyrore, të krijuara nga veprimi i kombinuar i faktorëve fiziko-gjeografikë që paraqesin vlerë të shtuar për mbrojtje. Kështu, varësisht prej faktorëve që kanë ndikuar në krijimin e tyre vlerat e trashëgimisë natyrore në

këtë zonë mund të ndahen në vlera të trashëgimisë me karakter, gjeologjik, gjeomorfologjik, speleologjik, hidrologjik, biologjik etj, të cilat kanë nevojë për ruajtje dhe menaxhim më të mirë me qëllim të valorizimit të tyre për qëllime turistike.

Në majën më të lartë të Pashtrikut në lartësinë perj 1900-1989 metra janë improvizuar dy varre njëri në territorin e Kosovës dhe tjetri në territorin e Shqipërisë, ku banorët nga të dy anët e kufirit realizojnë vizita gjatë stinës së verës, në muajin Korrik e Gusht. Ky është një pelegrinazh i karakterit pagan i trashëguar nga e kaluara, të cilin e organizon sekti islam i shijave.

GJENDJA EKZISTUESE NË MALIN PASHTRIK

Pjesa prej Drinit deri në kufirin me Shqipërinë quhet Hasi i Kosovës-Hasi i Thatë, i cili deri vonë ka qenë relativisht i izoluar, ku si barrierë kryesore ka qenë Drini i pa kapërcyeshëm. Ndërsa tani përmes urave lidhet Rogova me Xërxe dhe Landovica me Gjonaj. Regjioni i Pashtrikut është i pasur me vlera peizazhore estetike, shkencore, historike, kulturore, rekreative etj. Pjesa më e madhe është e mbuluar me pyje dhe ka më pak tokë pune. Në kuadër të kësaj zone në disa pjesë vërehen dëmtime të vegjetacionit të cilat janë si rezultat i ndikimeve negative të faktorit njeri. Pjesa me e madhe e këtij regjioni është e ndërtuar nga shkëmbinjtë gëlqeror, të cilët ndikojn në mungesën e sasisë së ujit në këtë pjesë.



Fig. 4. Dëmtimi i vegjetacionit pyjor



Fig. 5. Mungesa e burimeve ujore në Pashtrik

LIQENI I VËRMICËS

Liqeni i Vërmicës është vazhdim i Liqenit artificial të Fierzës, i cili është krijuar në rrjedhën e poshtme të Drinit të Bardhë në dalje të lumit në territorin e Shqipërisë. Lartësia mbidetare është prej 274 metra dhe me sipërfaqe prej 266 hektar. Liqeni i Vërmicës nga viti 1978 është në funksion të hidrocentralit të Fierzës.

Sipërfaqja e liqenit është shumë e ndryshueshme dhe varet nga sasia e prurjes së ujit të Drinit të Bardhë. Maksimalja e tyre arrihet gjatë muajve: dhjetor - maj, ndërsa në periudhat me mungesë te reshjeve sipërfaqja e liqenit zvogëlohet dukshëm duke përfshirë vetëm shtratin e lumit Drini i Bardhë në muajt qershor - nëntor.

Prurja mesatare vjetore e ujit e Drinit të Bardhë në Vërmicë është 74 m^3/sec, me oscilime prej 95 m^3/sec (nga 113m^3/sec në muajin maj në 18 m^3/sec në muajin gusht). Zona e liqenit të Vërmicës diferencohet me ndërtim kompleks ku janë konstatuar formacione diabazo-strallore të jurës së epërme. Ne ketë zonë lumi ka krijuar gryken epirogjenike të Nashecit e cila paraqet monument të rëndësishëm të karakterit gjeomorfologjik.



Fig. 6. Pamje nga Liqeni i Vërmicës

GJENDJA EKZISTUESE NË LIQENIN E VËRMICËS

Gjendja aktuale në Liqenin e Vërmicës mund të konstatohet se është e relativisht e mirë, mirëpo, në disa vende ka hedhje të mbeturinave ilegael nga faktori njeri. Këto mbeturina janë shkatuar nga si rezultat i djegieve që janë bërë nga vizitoret që të kanë qëndruar në afërsi të tij. Andaj, kjo dukuri e ndryshon pamjen e përgjithshme dhe njëkohësisht shkakton ndotjen e sipërfaqes tokësore dhe ujore të liqenit.



Fig. 7. Mbeturinat në afërsi të Liqenit të Vërmicës

Në afërsi të Liqenit të Vërmicës si zonë e cila është propozuar për mbrojtje aktualisht janë duke u zhvilluar aktivitete të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me sektorin e hotelerisë. Hotelet së bashku me objektet e tyre përcjellëse të cialt aktualisht po zhvillojn aktivitetin e tyre, janë të ndërtuara në pronësi publike, pa leje përkatëse.

Ndërtimet ilegale janë të shumta në anë të ndryshme të kësaj zone, ky fenomen është në vazhdimësi, ku përveç objekteve hoteliere, buzë liqenit janë ndërtuar edhe disa shtëpi, aktualisht të pa banuara. Të gjitha ndërtimet, që planifikohen të bëhen në këtë pjesë duhet të posedojnë lejen nga komuna, në të kundërtën si të tilla trajtohen në kundërshtim me ligjin.



Fig. 8. Hotelet dhe Restoranet te Liqeni i Vërmicës

BIODIVERSITETI I PASHTRIKUT

Regjioni i Pashtrikut paraqet një mozaik të vërtetë me vegjetacion heterogjen, në shtrirjen vertikale të cilit mund të dallojmë disa zona të fitocenozave me veti karakteristike për rajonin.



Flora

Bazuar në hulumtimet e deri tashme[4] është konstatuar se në malet e Pashtrikut, janë prezente me shumë se 1000 llojeve të bimëve vaskulare dhe 120 bimë mjekësore e aromatike, 56 lloje bimore (janë bimë endemike të Ballkanit), 12 lloje relikte, si dhe një lloj stenoendemik apo endemik lokal, pra lloji bimor Gjuhëqeni i Krasniqit (*Cynoglossum krasniqii* T. Wraber, 1986). Malet e Pashtrikut janë shumë të begatshme dhe karakteristike, në të cilat dominojnë këto lloje të familjeve: *Liliaceae, Poaceae, Fabaceae, Asteraceae, Rosaceae, Apiaceae, Rhamnaceae, Gesneriaceae,* Violaceae, Primulaceae, *Euonymus, Ligustrum, Viburnum, Lonicera* etj. Ndërsa llojet bimore prezente në këtë zonë janë: Zambaku Shqipëtar (*Lilium albanicum),* Zambaku i Martagonit (*Lilium martagon),* Filipendula e rëndomtë *(Filipendula hexapetala),* Barpezmi mijëfletësh (*Achillea milefolium*), *Sanëza (Gentiana lutea),* Shtara e bardhë (*Veratrum album),* Vadha e egër *(Sorbus aucuparia),* Genciana si kacekth *(Gentiana utriculosa),* Dhëmbëluani *(Leonthodon asper),* Rrush arushe (*Arctostaphylos uva ursi),* Bishtpelëza (*Festuca sp.),* Flokësa (*Poa sp.),* Kamespart shigjetake *(Genista sagitalis),* Badhra e bardhë *(Asphodelus albus),* Karajpeli (*Tanacetum vulgare),* Draba e Sharrit *(Draba scardicus),* Merkuriali shumëvjeçar *(Mercuralis perennis),* Hithëbuta e njollosur *(Lamium maculatum),* Ramonda serbe *(Ramonda serbica),* Lihnisi *(Lychnis coronaria),* Trifili i Pinjantit *(Trifolium pignantii),* Potentilla lulevogël *(Potentilla micrantha),* Ulëza (*Acer tataricum),* Kulumbria *(Prunus spinosa),* Shikakuqi malit (*Euonymus verrucosa),* Plenëra shelgore *(Inula salicina),* Vingjra e zezë (*Lathyrus niger), Dashtra e Ballkanit* (*Acanthus balcanicus*), Telishi lëmshor (*Dactylis glomerata*), Vjexha e zezë (*Cytisus nigricans),* Kufilma zhardhokore (*Symphytum tuberosum),* Rigoni i rëndomtë *(Origanum vulgare),* Manushaqja (*Viola odorata),* Cefalantera e kuqe *(Cephalanthera rubra),* Lulekambana gjethepjeshkë *(Campanula persicifolia),* Krokusat (*Crocus),* Manushaqet (*Viola),* Aguliçe (*Primula),* Pinguikula lulekreshte *(Pinguicula cristallina subsp. hirtiflora (Ten.)* Genciana e Nopçës *(Gentiana pneumonanta L. subsp. nopcsae (Jav.),* të cilat janë të kërcënuara nga ndërtimet e paplanifikuara veçanërisht në zonën e Qafë Morinës. Mandej llojet Stelara *(Stelaria holostea),* Knauta e dushkajave *(Knautia drymeia),* Kuqla dhëmbëqeni *(Erythronium dens-canis),* Manushaqja e Rikenbaut *(Viola silvestris),* Ngjitësja erëmirë *(Asperula odorata),* Merkuriali shumëvjeçar *(Mercuralis perennis),* Gage e verdhë *(Gagea lutea),* Tulipani *(Tulipa launica),* Solenantë Krasniqi *(Solenanthus Krasniqi Wraber, syn. Cynoglossum krasniqii T. Wraber),* Fritilara greke *(Fritillaria graeca Boiss et Sprun),* Kokoçel i Koshaninit *(Centaurea kosaninii Hayek),* Mylqinë *(Berberis vulgaris L.) etj.* Disa lloje të bimëve shihen në fotot vijuese[5].

[4] Hulmtimet nga Krasniqi, 1972; Rexhepi & Ruzic, 1985; Rexhepi, 1985; 1994; Wraber, 1985; 1990; Mustafa, 1999; Veselaj, 2006, si dhe hulumtimet gjatë vitit 2012-2014

[5] Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës – PRISHTINË, 2013



Solenatë Krasniqi
(Solenanthus Krasniqi)



Fritilara greke
(Fritillaria graeca)



Kokoçel i Koshaninit
(Centaurea kosaninii Hayek.)



Mylqinë
(Berberis vulgaris L.)

Llojet endemike të Ballkanit

Llojet endemike të Ballkanit prezente në Malin e Pashtrikut janë: Panja *(Acer obtusatum Waldst. & Kit.)*, Barpezmi i Baldacit *(Achillea baldacii Deg.)*, Barpezmi balukeartë *(Achillea chrysocoma Friv.)*, Barpezmi *(Achillea canescens)*, Barpezmi i Frazit *(Achillea fraasii Sch. Bip.)*, Barpezmi *(Achillea holosericea Sm.)*, Antilida e praruar *(Anthyllis aurea Welden.)*, Asteri Shqipëtar *(Aster albanicus Degen.)*, Kokoçeli i Koshaninit *(Centaurea kosaninii Hayek.)*, Cerasti *(Cerastium decalvans Schloss. et Vuk.)*, Gjuhëqeni i Krasniqit *(Cynoglossum krasniqii T. Wraber.)*, Karafili *(Dianthus behriorum Bornm.)*, Karafili i Pançiçit *(Dianthus pancici)*, Karafili i padhëmbëzuar *(Dianthus intiger Vis.)*, Luletogëzi i lëmuar *(Digitalis laevigata Waldst. & Kit.)*, Grosha e egër *(Dioscorea balcanica Kosanin.)*, Draba e Sharrit *(Draba scardica (Griseb.) Degen &* Dörfl.), Gjembbardhi pëllëmbor *(Eryngium palmatum Pançiç & Vis.)*, Purthiderthi *(Erysimum pectinatum Bory & Chaub.)*, Rrielli me lule të shogëta *(Euphorbia glabriflora Vis.)*, Rrielli malazez *(Euphorbia montenegrina (Bald.) K.Malý.)*, Fritilare Greke *(Fritillaria graeca Boiss et Spruner.)*, Boshtra *(Forsythia europeae Degen & Bald.)*, Fumana e Bonapartit *(Fumana bonapartei Maire & Petitmengin)*, Gjineshtra e Hasertit *(Genista hassertiana Bald.)*, Genciana e Nopçës *(Gentiana pneumonanta L.subsp. nopcsae (Jav.)T.)*, Halaça e Sendtnerit *(Halacsya sendtneri (Boiss.) Dorfler.)*, Akës i palosur *(Helichrysum plicatum DC.)*, Shpendra *(Helleborus multifidus Vis.)*, Shpendra serbe *(Helleborus serbicus Adam.)*, Këmasha *(Hieracium waldsteinii Tausch.)*, Pulithi i otoanit *(Jacobaea othonnae) (M. Bieb.) C. A. Mey.*, Zambaku shqipëtar *(Lilium albanicum Griseb.)*, Linaria e Peloponezit *(Linaria peloponnesiaca Boiss. Et Held.)*, Lunare telekiane *(Lunaria telekiana Ják.)*, Esparsetë e Sharrit *(Onobrychis montana subsp. scardica (Griseb.) P. W. Ball.)*, Cefalare e Pashtrikut *(Cephalaria pastricensis Dorfler & Hayek.)*, Këmasha *(Hieracium waldsteinii)* etj.



Cefalare e Pashtrikut
(Cephalaria pastricensis)



Këmasha
(Hieracium waldsteinii

Llojet bimore relikte në Pashtrik

Në kuadër të llojeve bimore relikte të cilat janë konstatuar në Pashtrik janë 12 lloje, prej të cilave katër lloje janë bimë relikte glaciale si: Rrush arusha *(Arctostaphylos uva-ursi (L.) Spreng.),* Sanëza (*Gentiana lutea* L.), Ylli alpin (*Aster alpinus* L.), Driada tetëpetëlshe *(Dryas octopetala* L.). Përveç bimëve të lartpërmendura, në këtë zonë gjenden edhe tetë lloje bimore relikte termofile të tercierit si: Asineumë gjethelimoni (*Asyneuma limonifolium* (L.) Janch.), Lulekëmbana llapore (*Campanula lingulata* Waldst. & Kit.), Cermëdelli (*Cotinus coggygria* Scop.), Ramonda serbe (*Ramonda serbica* Pancic.), Urthi (*Hedera helix* L.), Mëllëza (*Ostrya carpinifolia* Scop.), Rrobulli *(Pinus heldreichii* H. Christ.), Grosha e egër (*Dioscorea balcanica* Kosanin).

Llojet bimore të rrezikuara

Nga hulumtimet e deritanishme është konstatuar se populacionet e disa llojeve bimore endemike në zonën e Pashtikut janë të rrezikuara. Në kuadër të tyre po përmendim këto lloje: Gjuhëqeni i Krasniqit (*Cynoglossum krasniqii* T. Wrab.), numëron 35 individ, Karafili (*Dianthus behriorum* Bornm.) 800 individ, Pinguikula lulekreshte *(Pinguicula crystallina subsp. hirtiflora* (Ten.) (Strid)) 700 individ dhe Genciana e Nopçës (G*entiana pneumonanta L. subsp. nopcsae* (Jav.) T. Wraber) vetëm me 150 individ etj.



Karafili
(Dianthus behriorum)



Serratulë rrezore
(Serratula radiata B. M. a Bieb.)

Llojet e tjera të rrezikuara, janë: Sanguisorba Shqipëtare (*Sanguisorba albanica* András. & Jáv.), Antilida e praruar (*Anthyllis aurea* Welden.), Kakris si ferule (*Cachrys ferulacea* Calest.), Lulekëmbana qimekuqe (*Campanula trichocalycina* Ten.), Karafili (*Dianthus tristis* Velen.), Rrielli me lule të shogëta (*Euphorbia glabriflora* Vis.), Sanëza (*Gentiana lutea* L. Subsp. *symphyandra* Murb.), Shpendra (*Helleborus multifidus* Vis.), Shpendra serbe (*Helleborus serbicus* Adam.), Serratulë rrezore *(Serratula radiata) etj.*

Po ashtu rreth 10 lloje të bimëve të rrezikuara gjenden edhe në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës, si: Kokoqeli i Albertit (*Centaurea Albertii* Rexhepi), Skabiozë gjethebari *(Scabiosa graminifolia L),* Pulith i Skopolit (*Senecio scopolii* Hoppe & Hornsch), Pjerzë kërace (*Rhamnus pumila* Turra), Zhabinë ilirike (*Ranunculus illyricus* L.), Lule bozhure mashkull (*Paeonia mascula* (L.) Mill), Kokoçel purpur i errët (*Centaurea atropurpurea* Waldst. et Kit) etj.



Bozhure mjekësore
(Paeonia officinalis)

Në Pashtrik janë gjetur edhe 13 lloje bimore të rrezikuara globalisht, bazuar në kriteret e IUCN-itm, si: Barpezmi gjethekrithme *(Achillea crithmifolia* Waldst. & Kit.), Shkoza e bardhë *(Carpinus betulus* L.), Shkoza e zezë *(Carpinus orientalis* Mill.), Bar ethesh (*Centaurium erythraea* Rafn.), Xhërrokulli vjeshtor (*Colchicum autumnale* L.), Lajthia e egër (*Corylus collurna* L.), Lajthia (*Corylus avellana* L.), Epilobi qimeashpër (*Epilobium hirsutum* L.), Fritilare greke (*Fritillaria graeca* Boiss et Spruner.), Bozhure mjekësore (*Paeonia officinalis* L.), Rrobulli *(Pinus heldreichii* H. Christ.), Ramonda serbe *(Ramonda serbica* Pancic.) dhe Marina me katër theke (*Tamarix tetrandra* Pall. ex M.Bieb.).

Llojet bimore të reja për Pashtrikun

Gjatë hulumtimeve në Pashtrik, janë konstatuar tri lloje bimore të reja, e këto janë: Xhixhlla Ilire *(Onopordum illyricum* L.), Qepa e Kupanit (*Allium cupani* Raf.) dhe Xërxelja e Koshaninit *(Daphne kosaninii* Stoj.) e cila paraqet lloj të ri jo vetëm për florën e Pashtrikut, por edhe për florën e Kosovës.



Xhixhlla Ilire
(Onopordum Illyricum)

Vegjetacioni

Vegjetacioni i Malit të Pashtrikut përbehet nga 20 asociacione bimore siç janë: *Quercetum frainetto cerris scardicum, Quercetum trojana dukagjini, Dioscoreo- carpinetum orientalis, Quercetum pubescentis cerris, Ostryo-Quercetum cerris, Colurno-Ostryetum carpinifolia, Polygalo-Forsythietum europeae, Polygalo-Gensitetum hassertianae, Astero-Juniperetum oxycedri, Teucrio-Artemisietum camphoratae, Echinaria-Convoletum altheoides, Fagetum moesiaca montanum, Abieti-Fagetum moesiaca, Inulo-Danthonietum alpinae, Centaureo-*

Trifolietum velenovsxky, Fagetum subalpinum, Potentillo-Anthylletum montanae, Coronillo-Arctostaphylletum uvae ursi, Erico-Quercetum petraeae serpentinicum, Ostryo-Fagetum[6]. Prej të cilave dy asociacione janë endemikë si: *Polygalo-Forsythietum europeae dhe Polygalo-Gensitetum hassertianae* dhe dy të tjera janë asociacione relikte si: *Dioscoreo- carpinetum orientalis dhe Colurno-Ostryetum carpinifoliae.*

Në rajonin kodrinor të Pashtrikut shtrihen pyjet e shkozës së zezë, të bardhë dhe ato të dushkut, kurse në lartësi më të mëdha mbidetare pyjet e ahut të përziera me panjë, pastaj pyjet e haloreve dhe në zonën e fundit shtrihet vegjetacioni i kullosave.

Vegjetacioni pyjor në këtë pjesë është dëmtuar në masë të konsiderueshme si rezultat i djegies me zjarr, nga pas lufta.

Pyjet e shkozës së zezë dhe të bardhë

Këto fitocenoza shtrihen në pjesët kodrinore të regjionit të Pashtrikut. Kanë një sipërfaqe mjaft të madhe, duke filluar prej rrëzës së kodrave e deri mbi fshatin Demjan, në veri, pastaj mbi Lubizhdë e Karashëngjergj, në verilindje, si dhe mbi Gjonaj e Mazrek, në jug. Kufiri i epërm nuk është i prerë, por gradualisht kalon në pyje të bungut dhe ahut, ndërsa pyjet e shkozës nuk janë të vjetra por në zhvillim e sipër.

Përbërja floristike - këto pyje përfshijnë drunjtë gjetherënës të trevës me lagështi ose të thatë të pasura me materie ushqyese. Nuk gjenden në bashkësi të thjeshtë, por të përziera me bung, qarr, frashër, etj. Llojet karakteristike janë: Shkozëbardha *(Carpinus betulus),* Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), Mëllëza (*Ostrya carpinifolia*), Gorica (*Pyrus amygdaliformis*), Bungëbuta *Quercus pubescens,* Milëza (*Coronilla emerus*).

Katshmëria - këtu dallojmë katin e bimëve barishtore te cilat zhvillohen herët në pranverë dhe vonë në vjeshtë kur është pika maksimale e ndriçimit. Mirëpo disa nuk kanë nevojë për dritë aq të fortë, kështu që zhvillohen edhe gjatë periudhave të tjera vegjetative. Gjatë periudhës vegjetative dominon kati i shkurreve, gjysmëshkurreve dhe drurët jo aq të lartë. Pyjet e shkozës së zezë janë mjaftë të degraduara nën ndikimin e faktorit antropogjen. Për këtë shkak kohëve të fundit dominon frashëri, sidomos nëpër vendet ku ndihet mangësi e dheut.

Pyjet e dushkut

Pyjet e dushkut janë me një sipërfaqe mjaft të madhe dhe në kuadër të tyre ka ndërprerje të shumta, kështu që në disa vende ndërrohen përbërësit e pyllit. Këto pyje e mbulojnë pjesën më të madhe kodrinore prej rrëzës së kodrës buzë Drinit deri në kufi me ahishtën apo bredhin, në verilindje dhe se janë të reja në zhvillim e sipër.

[6] Hulumtimet nga Rexhepi (1986, 1994)

Përbërja floristike - kjo fitocenozë përfshinë pyje dhe shkurre gjetherënëse të cilat zhvillohen në toka bazike të dobëta dhe neutrale. Nuk janë si bashkësi të thjeshta, por të përziera. Edifikatorë kryesorë është gjinia e Dushkut *(Quercus)* me llojet Bungëbuta *(Q. pubescens),* Qarri *(Quercus. Cerris),* Shpardhi *(Quercus frainetto),* kurse në pjesën jugore afër luginës së Drinit, haset edhe Qarraziu *(Quercus trojana macedonica).* Karakteristike e kësaj është se edhe gjatë dimrit gjethet nuk i lëshon, por i mbanë të gjelbra, është bimë tipike e vendeve të nxehta subtropikale- mesdhetare. Në pjesën lindore në kufirin në mes të ahishtës dhe të dushkut është hasur edhe një bime tjetër me karakteristika të bimëve mesdhetare, nga familja *Thymeliaceae,* Jorgovani malit (*Daphne moeserium*), gjendet në vendin e quajtur Gjarpër, ndërkaq Xërxelja e Bllagajt (*Daphne blagayana*) shkon edhe në thellësi të ahishtës nëpër vende të ndriçuara. Këto dy gjini janë në zhdukje e sipër. Përgjatë luginës së Drinit të bardhë me pyje të dushkut gjendet edhe Cermëdelli (*Cotinus coggygrya* Scop.,) që vende vende edhe dominon. Ky lloj gjendet në luginën në mes të fshatit Krajk dhe Zym, në afërsi të Zymit, në luginën e Deshticës, si dhe mbi fshatin Bregdrini, duke i dhënë pyllit ngjyrën karakteristike të kuqërremtë. Para disa dekadave kjo bimë masovisht është mbledhur nga banorët e këtyre trevave, për qëllime industriale, për regjie të lëkurës, nxjerrjen e ngjyrave etj. Pjesën më të madhe të këtyre pyjeve e përcjellë edhe frashri, por njëkohësisht është e përzier edhe me shkozë.

Katshmëria - kati i bimëve më të ulëta janë myshqet të cilat zhvillohen nëpër trungje të bungut dhe gjatë periudhës dimërore nuk thahen, por mbesin përherë të gjelbra. Herët në pranverë zhvillohen bimët barishtore të larta mund të rriten deri në 50 cm. Kati i drurëve të ulët është shumë karakteristik dhe këtë e përbëjnë shumica e pemëve të egra, siç janë: thana, lajthia, kumbullat, murrizi, etj. Kati i fundit është ai i drurëve të lartë si: dushku, krekëza, shkoza, dardhishtat etj, të cilat janë degraduara, nga faktorit njeri. Pyjet e dushkut janë të përbëra nga këto asociacione të ndryshme bimore: *Quercetum pubescentis-cerris* dhe *Quercetum cerris farnetto scardicum,* që shtrihen në rrëzë të malit, duke vazhduar më lartë me asociacionin e *Quercetum trojana dukagjini,* ndërsa pjesa e sipërme e pyjeve të dushkut në ekspozicionin jugor janë asociacionet *Ostryo-Quercetum cerris* dhe *Colurno- ostryetum carpinifolia.* Në rrëzë të Pashtrikut, në afërsi të përroit shtrihet asociacioni *Dioscoreo- carpinetum orientalis.*



Qarraziu *(Quercetum trojana dukagjini)*

Në substratin gëlqeror të Pashtrikut shtrihen asociacionet bimore të tilla si: *Artemisietum-teucrio camphoratae* që paraqitet në ekspozicionet jugore deri në 800 metra lartësi mbidetare, *Echinaria-convoletum altheoides* që shtrihet në skajin jugor të lumit Drini i Bardhë. Mandej *Trifolietum-Centaureo velenovsxky* në ekspozicionin jugor në lartësi mbidetare prej 800 metra, *Inulo-Danthonietum alpinae, Potentillo-Anthylletum montana* dhe *Coronillo-Arctostaphylletum uvae ursi*, që shtrihet mbi zonën e pyjeve të dushkut dhe ahut. Ndërsa në substratin serpentin shtrihen bashkësitë endemike bimore të *Polygalo- Forsythietum europeae, Polygalo-Gensitetum hassertianae*, ndërsa prej shkurreve dominojn këto lloje: Bungu (*Quercus petraea* (Mattuschka) Liebel.), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.) dhe Boshtra (*Forsythia europaea* Degen.).

Pyjet e ahut

Në ekspozicionin veriperëndimor të malit gjendet zona e pyjeve të ahut dhe e ahut të përzier me halore, siç janë bashkësitë bimore të *Fagetum moesiaca montana, Fagetum subalpinum* dhe *Abieti- Fagetum moesiaca*, e cila diferencohet në nënzonën e ulët dhe atë të lartë. Nënzona e ulët shtrihet në pjesën perëndimore të fshatit Lubizhdë, në lartësi jo shumë të madhe mbidetare, mbi zonën e dushkut. Ndërsa nën zona e lart është e shtrirë deri te zona e pyjeve halore. Dallimi ndërmjet dy nën zonave është në përbërjen floristike dhe të lartësisë së shtrirjes. Nën zona e parë dallohet me trungje normale dhe me kurora mirë të zhvilluar. Mirëpo nën zona e dytë dallon me atë se trungjet deformohen më tepër nga ana e borës gjatë dimrit. Rajoni i Pashtrikut më tepër i ka të zhvilluara trungjet në pjesën veri-perëndimore nga se ahu kërkon kushte të lagështisë më të madhe dhe temperatura më të ulëta.

Përbërja floristike - në pranverën e hershme gjerë sa nuk zhvillohen gjethet e trungjeve të larta, me shpejtësi shumë të madhe zhvillohen efemeroidet pranverore. Në pjesën e dytë të pranverës toka mbulohet plotësisht me hije të gjetheve, kështu që jeta i mundësohet vetëm bimëve të vendeve me hije, siç janë fieroret etj. Llojet karakteristike janë: Ahu *(Fagus moesiaca), Ahu (Fagus silvatica),* Panja e malit *(Acer pseudoplatanus),* Kreka *(Acer campestris),* Jargovan *mali (Daphne mezereum)*

Katshmëria – këtu dallohen dy kate, ai i bimëve barishtore efemeroide që zhvillohen herët në pranverë dhe kati i drurëve të lartë. Pyjet e ahut janë të degraduara nga ana e njeriut dhe nga zjarri dhe në disa vende janë paraqitur plepat. Mirëpo me kalimin e kohës ato gradualisht janë ripërtërir, duke e marr formën e mëparshme.

Pyjet halore

Shtrihen në pjesën veri perëndimore dhe lindore të Rajonit të Pashtrikut dhe sipërfaqja e këtyre pyjeve në krahasim me pyjet e ahut është shumë më e vogël. Këto pyje shtrihen në formë të një rripi të gjatë duke filluar mbi zonën e pyjeve të ahut deri te kullosat e ashtuquajtura Livadhi i qëndisur. Në pjesën jugore nuk gjenden, por ato fillojnë prej pjesës lindore në formë të rripit

kah perëndimi deri te i ashtuquajturi liqeni i Bytyqit, në kufi me Republikën e Shqipërisë. Këto male janë mjaft të vjetra dhe drurët janë të vendosur më rrallë në krahasim me ahishtën. Kjo zonë është përherë e gjelbër, prej llojeve drunore gjendet Pisha *(Pinus sylvestris).* Këto pyje janë më pak të degraduara për shkak të vështirësisë të kalimit të terrenit, por gjatë periodave dimërore këto pyje shumë dëmtohen nga dëbora. Zona e kullosave shtrihet në majën e Rajonit të Pashtrikut, kufiri i poshtëm është zona e pyjeve halore, kurse si kufi i epërm është vet maja e Pashtrikut e lartë 1989 metra lartësi mbidetare. Kushtet klimatike janë të vështira për vegjetacion. Deri në pranverën e vonshme bora nuk shkrihet në maja, kurse gjatë verës ndihet thatësi shumë e madhe e përcjellë me temperatura të larta. Bimët shumë shpejtë e kalojnë periodën vegjetative.

Përbërja floristike - është shumë i begatshme me lloje karakteristike, shumica janë bimë barishtore të larta deri në një metër. Përveç kësaj hasen edhe disa shkurre të vogla, të shpërndara nëpër bimë barishtore. Ekosistemet më të rëndësishme janë: pyjet e ahut, dushkut, shkurret, livadhet dhe kullosat.

Fauna

Pashtriku është i pasur edhe me lloje shtazore ndonëse për grupe të caktuara nuk dihet ende numri i saktë i llojeve prezent. Në këtë pjesë gjenden lloje të ndryshme të faunës si: shpezë, gjitarë, zvarranikë, ujë tokësorë, etj. Mirëpo ende nuk dihet saktë numri i përgjithshëm i llojeve të këtyre grupeve shtazore, sepse por për shkaqe të prezencës së minave në zonën e Pashtrikut, mungesës se fondeve dhe kapaciteteve të pamjaftueshme, nuk është bërë hulumtimi i tyre. Kjo zonë paraqet një korridor natyror të rëndësishëm që lidhë Bjeshkët e Nemuna me Malet e Sharrit dhe Korabin.

Gjitarët e mëdhenj si Rreqebulli (*Lynx lynx balcanicus*), Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus*) etj, deri para ndërtimit të Rrugës së Kombit mendohet se e kanë shfrytëzuar këtë korridor për të lëvizur nga zona e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" në atë të "Sharrit" dhe anasjelltas, por pas ndërtimit të autoudhës ky qarkullim është ndërprerë. Me shpalljen e Pashtrikut zonë të mbrojtur dhe ngritjen e një mbikalimi të gjelbër - urë ekologjike, mbi këtë auto udhë do tu mundësohej shtazëve të egra të lëvizin lirshëm nga njeri Park Kombëtar tek tjetri. Gjatë hulumtimeve në terren janë hasur edhe disa grupe tjera të shtazëve si: Breshka e pyllit (*Testudo hermani),* Hardhucat (*Lacerta agilis dhe Lacerta viridis)* dhe insekte të ndryshme.



Breshka *(Testudo hermani)*



Zhapiu i shpejtë (*Lacerta agilis)*



Zhapiu i gjelbër (*Lacerta viridis)*

Fluturat – këto lloje të faunës janë ndër grupet më të hulumtuara të shtazëve në kuadër të Malit të Pashtrikut. Nga hulumtimet e mëparshme janë konstatuar gjithsejtë 98 lloje të fluturave, të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese. Prej tyre 95 lloje të flutura janë të listuara në "Librin e Kuq të Fluturave të Evropës"[7]. Në vazhdim janë paraqitur disa fotografi me lloje të ndryshme të fluturave që janë prezentë në Malin Pashtrik.



Polyommatus icarus



Pieris mannii



Colias alfacariensis

Nga hulumtimet e tanishme në terrenin e Pashtrikut, për herë të parë janë konstatuar tri lloje të fluturave e këto janë: *Neohiparchia fatua* (Freyer, 1844)(LC- IUCN), *Colias caucasica balcanica* (Rebel, 1901)(LC- IUCN), *Neohiparchia statilinus* (Hufnagel, 1766)(NT- IUCN).



Neohiparchia fatua



Colias caucasica balcanica



Neohiparchia statilinus

Në vazhdim gjendet tabela në të cilën është paraqitur lista me llojet e ndryshme të fluturave që janë gjetur gjatë hulumtimeve faunistike të bëra në Malin Pashtrik.

[7] Hulumtimet nga Jaksic, 1999; 2007

Famija	Gjinia	Lloji	Kategoritë e Listës së kuqe të IUCN-it (Europe)	Kategoritë e Listës së kuqe të IUCN-it (EU27)
Hesperiidae	*Erynnis*	*tages* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Hesperidae	*Carcharodus*	*lavatherae* (Esper, 1783)	NT	LC
Hesperidae	*Carcharodus*	*floccifera* (Zeller, 1847)	NT	NT
Hesperidae	*Spialia*	*phlomidis* (Herrich- Schaffer, 1845)	LC	LC
Hesperidae	*Spialia*	*orbifer*(Hubner, 1823)	LC	LC
Hesperidae	*Pyrgus*	*sidae* (Esper, 1784)	LC	LC
Hesperidae	*Pyrgus*	*malvae* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Hesperidae	*Pyrgus*	*serratulae* (Rambur, 1839)	LC	NT
Hesperidae	*Pyrgus*	*alveus* (Hubner, 1803)	LC	LC
Hesperidae	*Thymelicus*	*lineola* (Ochsenheimer, 1808)	LC	LC
Hesperidae	*Hesperia*	*comma* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Hesperidae	*Ochlodes*	*sylvanus* (Bremer & Grey, 1853)	LC	LC
Papilionidae	*Parnassius*	*mnemosyne* (Linnaeus, 1758)	NT	LC
Papilionidae	*Iphiclides*	*podalirius* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Papilionidae	*Papilio*	*machaon* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Pieridae	*Leptidea*	*sinapis* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Pieridae	*Leptidea*	*reali* (Resissinger, 1989)	LC	LC
Pieridae	*Anthocharis*	*cardamines* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Pieridae	*Euchloe*	*ausonia* (Hubner,1804)	LC	LC
Pieridae	*Aporia*	*crataegi* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Pieridae	*Pieris*	*brassicae* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Pieridae	*Pieris*	*mannii* (Mayer, 1851)	LC	LC
Pieridae	*Pieris*	*rapae* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Pieridae	*Pieris*	*ergane* (Geyer, 1828)	LC	LC
Pieridae	*Pieris*	*napi* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Pieridae	*Colias*	*croceus* (Fourcroy, 1785)	LC	LC
Pieridae	*Colias*	*alfacariensis* (Ribbe, 1905)	LC	LC
Pieridae	*Gonepteryx*	*rhamni* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Riodinidae	*Hamearis*	*lucina* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Lycaenidae	*Lycaena*	*phlaeas* (Linnaeus, 1761)	LC	LC
Lycaenidae	*Lycaena*	*virgaureae* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Lycaenidae	*Lycaena*	*candens* (Herrich- Schaffer, 1844)	LC	LC

Lycaenidae	*Thecla*	*betulae* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Lycaenidae	*Favonius*	*quercus* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Lycaenidae	*Callophrys*	*rubi* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Lycaenidae	*Satyrium*	*spini* (Denis & Schiffermuller, 1775)	LC	LC
Lycaenidae	*Satyrium*	*ilicis* (Esper, 1779)	LC	LC
Lycaenidae	*Satyrium*	*acaciae* (Fabricius, 1788)	LC	LC
Lycaenidae	*Cupido*	*minimus* (Fuessly, 1775)	LC	LC
Lycaenidae	*Celastrina*	*argiolus* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Lycaenidae	*Pseudophilotes*	*vicrama* (Moore, 1865)	NT	NT
Lycaenidae	*Scolitantides*	*orion* (Pallas, 1771)	LC	NT
Lycaenidae	*Glaucopsyche*	*alexis* (Poda, 1761)	LC	LC
Lycaenidae	*Phengaris*	*alcon* (Denis & Schiffermuller, 1775)	LC	NT
Lycaenidae	*Plebeius*	*argus* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Lycaenidae	*Plebeius*	*idas* (Linnaeus, 1761)	LC	LC
Lycaenidae	*Plebeius*	*argyrognomon* (Bergstrasser, 1779)	LC	LC
Lycaenidae	*Aricia*	*eumedon* (Esper, 1780)	LC	LC
Lycaenidae	*Aricia*	*agestis* (Denis & Schiffermuller, 1775)	LC	LC
Lycaenidae	*Aricia*	*anteros* (Freyer, 1838)	NT	LC
Lycaenidae	*Polyommatus*	*semiargus* (Rottemburg, 1775)	-	-
Lycaenidae	*Polyommatus*	*dorylas* (Denis & Schiffermuller, 1775)	NT	NT
Lycaenidae	*Polyommatus*	*amandus* (Schneider, 1792)	LC	LC
Lycaenidae	*Polyommatus*	*icarus* (Rottemburg, 1775)	LC	LC
Lycaenidae	*Polyommatus*	*eroides* (Frivaldszky, 1835)	-	-
Lycaenidae	*Polyommatus*	*daphnis* (Denis & Schiffermuller, 1775)	LC	LC
Lycaenidae	*Polyommatus*	*bellargus* (Rottemburg, 1775)	LC	LC
Lycaenidae	*Polyommatus*	*coridon* (Poda, 1761)	LC	LC
Lycaenidae	*Polyommatus*	*admetus* (Esper, 1783)	LC	LC
Lycaenidae	*Polyommatus*	*damon* (Denis & Schiffermuller, 1775)	NT	NT
Nymphalidae	*Argynnis*	*paphia* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Argynnis*	*aglaja* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Argynnis*	*adippe* (Denis & Schiffermuller, 1775)	LC	LC
Nymphalidae	*Argynnis*	*niobe* (Linnaeus, 1758)	LC	NT
Nymphalidae	*Issoria*	*lathonia* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Brenthis*	*hecate* (Denis & Schiffermuller, 1775)	LC	LC
Nymphalidae	*Boloria*	*dia* (Linnaeus, 1767)	LC	LC
Nymphalidae	*Vanessa*	*atlanta* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Vanessa*	*cardui* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Aglais*	*io* (Linnaeus, 1758)	LC	LC

Nymphalidae	*Aglais*	*urticae* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Nymphalis*	*polychloros* (Linnaeus, 1758)	LC	VU
Nymphalidae	*Euphydryas*	*aurinia* (Rottemburg, 1775)	LC	LC
Nymphalidae	*Melitaea*	*cinxia* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Melitaea*	*athalia* (Rottemburg, 1775)	LC	LC
Nymphalidae	*Apatura*	*iris* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Kirinia*	*roxelana* (Cramer. 1777)	LC	LC
Nymphalidae	*Lasiommata*	*megera* (Linnaeus, 1767)	LC	LC
Nymphalidae	*Lasiommata*	*petropolitana* (Fabricius, 1787)	LC	LC
Nymphalidae	*Lasiommata*	*maera* (Linnaeus, 1785)	LC	LC
Nymphalidae	*Coenonympha*	*arcania* (Linnaeus, 1761)	LC	LC
Nymphalidae	*Coenonympha*	*pamphilus* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Pyronia*	*tithonus* (Linnaeus, 1767)	LC	LC
Nymphalidae	*Aphantopus*	*hyperantus* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Maniola*	*jurtina* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Hyponephele*	*lycaon* (Rottemburg, 1775)	LC	LC
Nymphalidae	*Erebia*	*medusa* (Denis & Schiffermuller, 1775)	LC	LC
Nymphalidae	*Erebia*	*ottomana* (Herrich- Schaffer, 1847)	LC	LC
Nymphalidae	*Erebia*	*melas* (Herbst, 1796)	LC	LC
Nymphalidae	*Erebia*	*oeme* (Hubner, 1804)	LC	LC
Nymphalidae	*Melanargia*	*galathea* (Linnaeus, 1758)	LC	LC
Nymphalidae	*Melanargia*	*larissa* (Geyer, 1828)	LC	LC
Nymphalidae	*Satyrus*	*ferula* (Fabricius, 1793)	LC	LC
Nymphalidae	*Hipparchia*	*fagi* (Scopoli, 1763)	NT	NT
Nymphalidae	*Hipparchia*	*syriaca* (Staudinger, 1871)	LC	LC
Nymphalidae	*Hipparchia*	*delattini* (Kudrina, 1975)	-	-
Nymphalidae	*Brintesia*	*circe* (Fabricius, 1775)	LC	LC
Nymphalidae	*Chazara*	*briseis* (Linnaeus, 1764)	NT	NT

Fig. 9. Lista e llojeve të fluturave që janë gjetur në Pashtrik

BIODIVERSITETI I LIQENIT TË VËRMICËS

E veçanta e kësaj zone është shumëllojshmëria e botës së gjallë të florës dhe faunës. Pjesët më të larta përreth liqenit janë të mbuluara me bashkësi të bimëve barishtore të pasura me bimë të rralla dhe endemike.

Liqeni i Vërmicës është i pasur me peshq të llojeve të ndryshme. Pas përfundimit të digës dhe mbushjes së basenit të Fierzës me ujë, fauna e Drinit të Bardhë dhe Liqenit të Vërmicës u shtua me lloje të ndryshme peshqish, si ballëgjeri (*Hypophthalmichthys sp.*), krapi (*Cyprinus carpio*) e

luçiperka (*Stizostedion lucioperca*) që u hodhën si rasatë në Liqenin e Fierzës dhe gjetën një mjedis shumë të përshtatshëm për t'u shumuar dhe ushqyer. Krijimi i këtij liqeni solli edhe zvogëlimin e ndoshta edhe zhdukjen e disa llojeve të peshqve që më parë popullonin Drinin e Bardhë, si ngjala (*Anguila anguila*) e peshq të ujërave të rrjedhshëm, por favorizoi rritjen e peshqve të liqeneve.

Sipas një hulumtimi të realizuar në vitin 2006, në kuadër të Liqenit të Vërmicës janë konstatuar gjithsej 10 lloje të peshqve[8]. Prej tyre mund të përmendim: krapin (*Cyprinus carpio*), ngjilën (*Chondrostoma nasus*), mlyshin (*Leuciscus cephalus*), mustakun (*Barbus barbus*), gjucën (*Leucaspius delineatus*), sharrokun (*Perca fluviatilis*) etj. Ndër gjitarët ujorë që jetojnë në ujërat e Liqenit të Vërmicës përmendim lundërzën (*Lutra lutra*).



Luçiperka *(Stizostedion lucioperca)*



Krapi *(Cyprinus carpio)*



Fig. 10. Llojet e ndryshme të shpezëve duke fluturuar tek Liqeni i Vërmicës

VLERAT PEIZAZHORE TË MALIT PASHTRIK DHE LIQENIT TË VËRMICËS

Mali Pashtrik - zona natyrore e Malit Pashtrik përveç vlerave biologjike, biogjeografike, gjeologjike, hidrologjike, karakterizohet edhe me vlera të veçanta peizazhore dhe estetike. Prandaj si e tillë paraqet vend shumë të rëndësishëm për vizitor, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore dhe hulumtuese në kuadër të tij.

[8] Hulumtimet nga L. Grapci, 2006



Fig. 11. Vlerat peizazhore të Malit Pashtrik

Vlerat peizazhore në këtë pjesë janë të gërshetuara me biodiversitet të pasur dhe karakteristik.



Fig. 12. Biodiversiteti i Malit Pashtrik

Liqeni i Vërmicës - paraqet zonë karakteristike në aspektin peizazhor për shkak se përmban pamje shumë të bukura të cilat janë mjaft tërheqëse për vizitorët që zgjedhin për të pushuar ose vizituar këtë pjesë. Po ashtu ofron mundësi për realizimin e aktiviteteve hulumtuese.



Fig. 13. Peizazh nga Liqeni i Vërmicës



Fig. 14. Biodiveristeti i Liqenit të Vërmicës

VEPRIMTARIA EKONOMIKE E MALIT TË PASHTRIKUT DHE LIQENIT TË VERMICËS

Veprimtaritë ekonomike në zonën e propozuar për Park të Natyrës/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmices" janë veprimtari tradicionale, kulturore, historike dhe rekreative. Këto veprimtari ofrojnë një varg shërbimesh të rëndësishme jo vetëm për ekonominë lokale por edhe atë kombëtare. Këto zona ofrojna mundësi ekonomike të ndryshme për zhvillimin e sektorit të turizmit dhe rekreacionit. Liqeni i Vërmicës ke resurse për zhvillimin e peshkatarisë. Në këtë zonë gjenden disa lloje të peshqëve prej të cilëve mund të përmendim: Luçiperka *(Stizostedion lucioperca)*, Krapi *(Cyprinus carpio)*, Saraga, Sharani, Mlyshi, Gërgeci etj. Këto lloje të peshqve aktualisht janë duke u gjuajtur nga peshkatarët vendor në sezona të caktuara, kurse prej 20 Prillit deri me 20 Qershor, përshkimi është i

ndaluar. Humbja e këtyre shërbimeve do të kishte ndikim madhor në mjetet lokale të jetesës dhe ekonominë në përgjithësi, por me zhvillim e menaxhim të përmirësuar dhe më racional vlera e këtyre shërbimeve mund të mbahet dhe rritet në masë të konsiderueshme.



Fig. 14. Vepritmarit ekonomike në Pashtrik dhe Liqenin e Vërmicës



Fig. 15. Rekreacioni në Liqenin e Vërmicës



Fig. 16. Peshkimi në Liqenin e eVërmicës

Aplikimi i mënyrave më të mira për zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm, mundëson që vlerat e këtyre shërbimeve të mbahen dhe të rriten në masë të madhe. Në të njëjtën kohë, shfrytëzimi i vlerave dhe shërbimeve të ofruara nga parku përmes ndërtimit dhe zhvillimit të qendrave turistike mund të sjellë të mira të konsiderueshme për parkun.

ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI ME ZONËN

Administrimi i zonës së propozuar për mbrojtje "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmices", në kategorinë Park Natyre/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare, do të bëhet nga Drejtoria që me Vendim e themelon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Nr.03/ L-233, Planin Hapësinor dhe Planin e Menaxhimit, si dhe dokumentet tjera strategjike.

Drejtoria që administron me këtë zonë do të kryen veprimtaritë e mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe përparimit të zonës së mbrojtur me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës burimore, sigurimin e papenguar të proceseve natyrore dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të mirave të natyrës, zbatimin e kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në zonë si dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarive të lejuara ekonomike me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit të qëndrueshëm të mirave të natyrës.

Menaxhimi do të bëhet në bazë të Planit të Menaxhimit i cili nxirret në kohëzgjatje prej dhjetë (10) viteve, me të cilin përcaktohen: kahet e zhvillimit, mënyra e mbrojtjes, shfrytëzimit dhe menaxhimit me zonën e mbrojtur dhe kahet më të përafërta për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të natyrës në zonën e mbrojtur duke pasur në konsideratë edhe nevojat e komunitetit lokal.

Menaxhmenti duhet të marrë në konsideratë diversitetin e peizazhit, ruajtjen e biodiversitetit dhe hapësirën për rekreacion, me mundësinë reale të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimin e ekoturizmit.

Personat juridik dhe fizikë të cilët kryejnë veprimtarinë e mbrojtjes të zonës së mbrojtur janë të detyruar ti përmbahen planit të menaxhimit.

Pas kalimit të periudhës prej pesë vjetësh, bëhet analiza e zbatimit të planit të menaxhimit dhe rezultatet e arritura dhe sipas nevojës bëhet revidimi i planit të menaxhimit sipas mënyrës dhe procedurës të përcaktuar për nxjerrjen e tij.

PËRFUNDIM

Duke marrë parasysh vlerat natyrore, veçanërisht biodiversitetin dhe larminë peizazhore të zonës dhe duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03 / L-233, Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës do të duhej të shpallet Park i Natyrës/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare, që sipas kritereve të IUCN-së, i takon kategorisë së pestë (5) të zonave të mbrojtura.

Mungesa e statusit të mbrojtjes dhe programeve të duhura për ruajtjen e biodiversitetit në Malin Pashtrik dhe Liqenin e Vërmicës, ndikon që shumë lloje bimore dhe shtazore të rrezikohen me zhdukje. Kështu që ky dokument do të shërbej si argument bazë për vënien e kësaj zone nën mbrojtjen ligjore.

Gjatë hartimit të Draft-dokumentit të Arsyeshmërisë profesionale "Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës", Grupi Punues ka propozuar për mbrojtje zonën me sipërfaqen prej **5762.57** hektar, apo **237.43** hektar më pak sesa që është përcaktuar në Vendim. Sipërfaqja prej 237.43 është paraparë të hiqet në mënyrë që të shmangen parcelat kadastrale që i takojn pronësisë private.

Gjatë përcaktimit të vijës kufitare, përveç vlerave natyrore që ka qenë kriter kryesore, është marrë parasysh edhe çështja e pronësisë, ku pjesa dërmuese e parcelave kadastrale të përfshira brenda zonës së propozuar për mbrojtje janë në pronësi publike.

Pronësia - Në zonën e propozuar për mbrojtje "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës", pasi janë mbledhur të dhënat nga parcelat kadastrale janë analizuar me qëllim të gjetjes së mundësisë për vërtetimin e çështjeve që lidhen me pronësinë, në territorin e dy komunave që përbëjnë tersinë e zonës së propozuar për mbrojtje.

Gjatë këtij procesi është konstatuar se në komunën e Gjakovës, nuk gjendet asnjë pronë private, por se të gjitha parcelat kadastrale janë në pronësi publike.

Ndërsa në pjesën që i takon komunës së Prizrenit vetëm një pjesë e vogël e parcelave kadastrale në zonën e Pashtrikut dhe disa tjera rreth Liqenit të Vërmicës janë në pronësi private, kurse pjesa më e madhe e tyre janë në pronësi publike.



Fig. 17. Përqindja e pronësisë nëpër Komuna



Fig. 18. Harta e pronësisë e "Malit Pashtrik dhe Liqenit të Vërmicës"[9]

Pas vënies nën mbrojtje të kësaj zone duhet hartuar dy dokumentet strategjike që janë: Plani Hapësinor dhe Plani Menaxhues, të cilët do të marrin në konsideratë parimet për zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë jo vetëm dimensionet mjedisore, por edhe ato sociale dhe ekonomike. Masat e nevojshme që duhet të ndermirën për zhvillimin e mëtejmë të zonës janë:

- Mbrojtja adekuate e të gjitha llojeve bimore të rrezikuara, duke përfshi edhe populacionet e bimës stenoendemike *Cynoglossum krasniqii T. Wrab*
- Mbrojtja adekuate e llojeve shtazore, si dhe vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme në aspektin floristik dhe faunistik
- Mundësia e ripërtëritjes së hapësirave të degraduara me bashkësi autoktone
- Mbrojtja adekuate nga zjarret eventuale
- Mos ndërtimi i objekteve të paplanifikuara
- Mos ndryshimi i rrjedhave dhe burimeve natyrore të ujit
- Përcaktimi dhe vënia e shenjave adekuate për kufijtë e zonës së mbrojtur të Parkut

[9] Burimi: Agjencioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit - Prishtinë, 2018

- Masat për pastrimin e tërësishëm të Masivit të Pashtrikut nga minat
- Promovimi i vlerave natyrore, turistike dhe prodhimeve tradicionale të zonës ndërkufitare

Në të njëjtën kohë, shfrytëzimi i vlerave dhe shërbimeve të ofruara nga parku përmes ndërtimit dhe zhvillimit të qendrave turistike mund të sjellë të mira të konsiderueshme për Parkun ose mund t'i zvogëlojë vlerat e saj dhe rrisë kostot e menaxhimit duke ofruar vetëm disa përfitime të prekshme, qoftë për Drejtorinë e Parkut të Natyrës qoftë për komunitetet lokale.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/ L-233 nenit 13 paragrafi 2, në Parkun e Natyrës/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare lejohen veprimtaritë ekonomike dhe aktivitetet tjera me të cilat nuk rrezikohet roli dhe karakteristikat e rëndësishme të tij. Prandaj shfrytëzimi i të mirave të natyrës në te përcaktohet me kushtet për mbrojtjen e natyrës e këto janë:

- Ndalimi i ndryshimit të gjendjes së vlerave natyrore të ekosistemeve në Pashtrik, si dhe gjendjes së resurseve ujore në Liqenin e Vërmicës
- Ruajtjen e kushteve të habitateve të domosdoshme për mbrojtjen e llojeve të rëndësishme, nën-llojeve, komuniteteve biotike ose karakteristikave fizike të mjedisit
- Ngritjen e zonave për edukimin mjedisor, si dhe vlerësimin e karakteristikave të habitateve për menaxhimin më të mirë të llojeve në natyrë
- Parandalimin e zhvillimit të aktiviteteve që janë në kundërshtim me qëllimet për të cilat zona merret nën mbrojtje
- Lejimi i hulumtimeve shkencore si dhe aktiviteteve parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore
- Ofrimi i mundësive për popullatën lokale që të sigurojnë përfitime ekonomike nga grumbullimi i frutave të malit, si dhe shfrytëzimi i drunjve për ngrohje për nevojat familjare që është një nga objektivat e menaxhimit

Shfrytëzimi i resurseve natyrore në përputhje me ruajtjen e natyrës është një nga qëllimet kryesore të kësaj zone. Primare për zonat që i takojnë kësaj kategori është mbrojtja e ekosistemeve natyrore ndërkufitare dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Përveç kësaj si qëllim tjetër duhet të përfshihet edhe promovimi i përfitimeve në aspektin social dhe ekonomik, konkretisht për komunitetin lokal, si dhe sigurimin e lehtësirave për jetesën e gjeneratave të ardhshme të komunitetit në këtë pjesë.

Projektet komunale të planifikuara në zonën e propozuar për mbrojtje

Gjakovë

Komuna e Gjakovës planifikon të bëjë studimin e fizibilitetit dhe hartimin e Projektit për ndërtimin e Qendrës Turistike në pjesën e quajtur "Maja e Kunorës". Ky Projekt ka për qëllim të ndikojë në zhvillimin e sektorit të turizmit, duke zhfrytëzuar resurset potenciale ekzistuese. Projekti do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në ngitjen e mirëqenies sociale.



Projekti

Qendra Turistike "Maja e Kunorës"



Projekti

Shtegu i Biçikletave "Gorozhup-Martinaj"

Prizren

Komuna e Prizrenit planifikon të bëjë studimin e fizibilitetit dhe hartimin e Projektit për ndërtimin e rrugës, konkretisht shtegut të biçikletave Gorozhup, Martinaj - regjioni i Hasit, pjesa e Kosovës e lidhur me rajonin e Hasit në Shqipëri. Qëllimi kryesor është zhvillimi i i infrastrukturës dhe krijimi i parakushteve teknike për realizimin e projektit të rrugës ndërkufitare. Projekti ka vlerë 50.000 euro dhe zbatues të tij janë Komuna e Prizrenit dhe Komuna e Kukësit, ndërsa kohëzgjatja do të jetë dymbëdhjetë muaj.

LITERATURA

1. Demiri, M., 1981: Flora ekskursioniste e Shqipërisë. Shtëpi Botuese e Librit Shkollor
2. Grapci, L., 2006: Ndikimi i faktorëve ekologjik në dinamikën e popullatave të llojeve të peshqve në lumin drini i bardhë, Disertacioni i doktorates, Universiteti i Prishtines
3. Krasniqi, F., 1972: Šumska vegetacija brdskog regiona Kosova. - Zajedn. nauč. ustan. Kosova. Studije 27: 1-133, Prishtinë
4. Krasniqi, F., 1987: Endemi u flori Kosova i problemi njihove zashtite. ANU. BiH. Posebna knjiga 83: 119-124, Sarajevo
5. Krasniqi, F., Ruci, B., Vangjeli, J., Susuri, L., Mullaj, A., Pajazitaj, Q., 2003: Fjalor i emrave të bimëve. ASHSH-Instituti i Kërkimeve Biologjike, Tiranë dhe ASHAK-Seksioni i Shkencave të Natyrës, Prishtinë
6. Rexhepi & Ruzic,1985: Association *Ostryo–Quercetum cerris, ass. Nova on Mt. Pashtrik.* Zbornik radova Simpozijuma" Stogodishnjice Flore bokoline Nisa", pp. 81- 87, Nis
7. Rexhepi F., 1986: Flora e maleve të larta të Kosovës. Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK, Botim i veçantë, Prishtinë
8. Rexhepi F., 2000: Kosovo endemics plants. University of Prishtina
9. Rexhepi, F., 1985: Flora of Mt. Pashtrik. I Kongres na biosistematicarite na Jugoslavia, pp. 80-81, Popova Sapka
10. Rexhepi, F., 1985: Sumska zajednica Quercetum pubescentis- Cerris Rxhepi As. Nov. Na podrucju Kosova (Sumska medunica i cera). Zbornik radova Simpozijuma" Stogodishnjice Flore bokoline Nisa", pp. 81- 87, Nis
11. Rexhepi, F., 1986: Vegetacija Planine Pashtrika. VII Kongres Biologa Jugoslavije. Plenarni Referat. I Izvod Saopstenja. Str. 215. Budva
12. Rexhepi, F., 1994: Vegetation of Kosova. University of Prishtina
13. Pajazitaj Q., 2004: Përcaktuesi i bimëve Pteridofite dhe Spermatofite, Universiteti i Prishtinës
14. Mustafa, B. et al. 2015: "The Pashtrik Mountain, a potential protected landscape area" Biologija. 2015. Vol. 61. No. 2. P. 73–82

15. Mustafa, B., 1998: "Basic characteristics of Flora and vegetation of Kosova an the danger of their disapperarance. AJNTS. Journal of Natural and Technical Sciences 5: Academy of Sciences of Albania.Tiranë
16. Mustafa, B., Hajdari, A., Hoxha E., Zhushi F., Veselaj, Z., 2008: Potential areas of biodiversity for the Ecological Network Natura 2000 in Kosovo. International Conference on Biological and Environmental Science. Tiranë
17. MMPH & UP: Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës - PRISHTINË, 2013
18. Çevani S. 2014 "Trashëgemia Natyrore e Hasit" – Punim i masterit, Derpartamenti i Gjeografisë – FSHMN, Prishtinë
19. Jaksic, P., 1999: New and rare species of Lepidoptera in Yugoslavia. *Acta entomologica Serbica, 4 (1/2)* 63- 71
20. Jaksic, P., 2003: Crvena knjiga dnevnih leptira Srbije (Lepidoptera: Hesperioidea and Papilionoidea). [Red Data Book of Serbian Butterflies]. Zavod za zaštitu prirode Srbije, str. 1-198, Beograd
21. Jaksic, P., 2007: Contribution to knowledge of the butterflies of mt. Pashtrik, Serbia. Acta Entomologica serbica, 12 (2) 55- 61
22. Kojic, M., & Pejcinovic, D., 1982: Korovska flora i vegetacije Kosova. Zavod za udzbenike i nastavna sredstva SAP Kosova, Posebna izdanja, str. 34-36, Prishtina
23. Veselaj, Z., Mustafa B., Krasniqi, F., & Hoxha E., 2006: Species of international significance and their distribution in Kosovo. Bulgarian Academy of Science, Proceedings of IV Balcan Botanical Congress
24. Mala, Xh. (2010): Flora vaskulare e maleve të Mushtishtit. Punim masteri. UP-FSHMN. Prishtinë
25. Milovanovic B., Ciric B., 1968: Geoloska karta, Zavod za geoloska i geofizicka istrazivanja Serbije. Beograd
26. Pavicevic, N., Grujic, U., Milosevic, LJ., Katalina, P. & Vasic, G. 1974: Pedološka karta SAP Kosova, Beograd
27. Wraber, T., 1985: Die Solenanthus-grupe Der Gattung Cynoglossum in Der Flora Jugoslawiens. Zbornik radova Simpozijuma " Stogodisnjica Flore bokoline Nisa" Nis

28. Wraber, T., 1986: Ein neres Cynoglosum (C. Krasniqii) aus Jugoslawien. Candolla (im Druck)
29. Wraber, T., 1990: De Gentiana nopcsae Javorka notua. Biol Vestn 38 (1990)3: 39-46. Ljubljana
30. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233. Kuvendi i Kosovës – Prishtinë, GZK (2010)
31. Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" Nr. 04/L-086. Kuvendi i Kosovës – Prishtinë, GZK (2013)
32. Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri" Nr. 04/L-087, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, GZK (2013)
33. Vendim Nr. 38 AMMK/2018, të datës 08.02.2018, për vënien nën Mbrojtje Paraprake të një pjese të Malit Pashtrik dhe Liqenit të Vërmicës, si zonë potenciale për shpallje Park i Natyrës/Zonë e Mbrojtur Ndërkufitare

Anëtarët e Grupit Punues

Nexhmije Kamberi, IKMN, Kryesuese _____

Sami Behrami, IKMN, Anëtar _____

Miradije Gërguri, DMMU, Anëtare _____

Përparim Gashi, SIM, Anëtar _____

Ibrahim Muja, MBPZHR, Anëtar _____

Fatos Deda, KK, Gjakovë, Anëtar _____

Xhejlane Gjini, KK, Prizren, Anëtare _____

Anëtarët e Grupit Punues ishin:

Nexhmije Kamberi, IKMN, Kryesuese _____

Sami Behrami, IKMN, Anëtarë _____

Miradije Gërguri, DMMU, Anëtare _____

Përparim Gashi, SIM, Anëtar _____

Ibrahim Muja, MBPZHR, Anëtar _____

Fatos Deda, KK Gjakovë, Anëtar _____

Xhejlane Gjini, KK Prizren, Anëtare _____